

**VENDIM****Nr. 140, datë 24.2.2016**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË,
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI
QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË “THE
STAR” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR
PASURINË “SALLA S4, ME AMBIENTET
E SAJ NDIHMËSE”, TË SHOQËRISË
“NPV” SHA, Durrës**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “The Star” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “Salla S4, me ambientet e saj ndihmëse”, në katin e tretë teknik (kati i katërt, nga toka, i godinës), në administrim të shoqërisë “NPV” sh.a., Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 550 (pesëqind e pesëdhjetë) m², përkatësisht, sipërfaqe nën objekt 550 (pesëqind e pesëdhjetë) m², sipas genplanit dhe tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

